



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Të dhëna mbi veprimtarinë e SPAK në lidhje me subjektet e vetting-ut për vitin 2021

Procedime penale të regjistruara

SPAK ka regjistruar 5 procedime penale të subjekteve të vetting-ut të cilët janë shkarkuar apo kanë dhënë dorëheqjen gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.



Ngritja e akuzës në gjykatën kompetente

Nga 5 rastet e regjistruara, SPAK ka dërguar kërkesën për gjykim në gjykatën kompetente për 4 prej tyre, ndërkohë për njërin nga rastet çështja është ende nën hetim.

80%

75%

25%

Nga 4 raste për të cilat SPAK ka depozituar kërkesë në gjykatën kompetente, është marrë vendim i formës së prerë për 3 prej tyre.

Ndërkohë për njërin nga rastet për të cilin SPAK ka depozituar kërkesën për gjykim, çështja është ende nën gjykim.



Veprat penale për të cilat janë gjetur fajtor

Ndër 3 vendime të formës së prerë të marra në vitin 2021, janë gjetur fajtor subjektet e vetting-ut për 2 lloje të veprave penale:

- Një herë për veprën penale të fshehjes ose deklarimit të rremë të pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim, **parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal.**
- Dy herë për veprën penale të korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë, **parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal.**